

VENDIM
Nr. 659, datë 8.10.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.677, DATË 16.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË NDËRTIMIT TË CENTRALIT ELEKTRIK ME ERË (PARQE EOLIKE), DHËNË SHOQËRISË "EN.ERGY", SHPK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.677, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës" zëvendësohet me "Ministria e Energjisë dhe Industrisë".

b) Në autorizimin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Në pikën 4, fjalët "... brenda datës 31 dhjetor 2015 ..." zëvendësohen me "... brenda datës 31 dhjetor 2022, në përputhje me afatet e zërave të punës sipas grafikut të zbatimit të punimeve, bashkëlidhur këtij autorizimi ...".

ii. Pas shkronjës "e", të pikës 8, shtohet shkronja "ë", me këtë përmbajtje:


"ë. "EN.ERGY", sh.p.k., nuk respekton afatet dhe kushtet e përcaktuara në grafikun e punimeve."

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AKTIVITETI	PERIUDHA		
NIVELI 1	DATA E FILLIMIT	Kohëzgjatja (dd)	DATA E MBARIMIT
Përgatitja e kantierit	9/1/2016	50	10/21/2016
Rrugët e lidhjes	10/22/2016	352	10/9/2017
Themelet	4/11/2017	445	6/30/2018
Kanali i kavos midis kullave eolike	3/1/2018	443	5/18/2019
Linja e lidhjes nga parku eolik tek nënstacioni	5/15/2019	240	1/10/2020
Kullat eolike dhe aerogjeneratorët	1/10/2020	963	8/30/2022
Linja e transmetimit Elbasan-Durrës*	7/1/2020	729	6/30/2022
Punime përgatitore dhe vepra aksesore linja e interkoneksionit Durrës-Puglia	2/1/2019	434	4/10/2020
Pozicionimi i kavos detare nga Durrësi për linjën e interkoneksionit	4/10/2020	933	10/30/2022
Vepra të ndryshme plotësuese	3/1/2018	1720	11/15/2022
Kontrollet e sigurisë së punimeve	9/1/2016	2281	11/30/2022
Kolaudimi i brendshëm	10/9/2017	1878	11/30/2022
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjën e interkoneksionit 500 MW AL-IT	11/30/2022	31	12/31/2022
Zgjerimi në 1.000 MW i linjës së interkoneksionit Durrës-Puglia	3/3/2025	576	9/30/2026
Kolaudimi i brendshëm zgjerimi nga 500 MW në 1,000 MW linja e interkoneksionit	9/30/2026	30	10/30/2026
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare zgjerimi në 1,000 MW linja e interkoneksionit AL-IT	10/30/2026	31	11/30/2026
*Ky programim është i lidhur me programimin për linjën e transmetimit dhe linjën e interkoneksionit			



AKTIVITETI	PERIUDHA		
NIVELI 1	DATA E FILLIMIT	Kohëzgjatja (dd)	DATA E MBARIMIT
Përgatitja e kantierit	9/1/2016	50	10/21/2016
Rrugët e lidhjes	10/22/2016	352	10/9/2017
Themelet	4/11/2017	445	6/30/2018
Kanali i kavos midis kullave eolike	3/1/2018	443	5/18/2019
Linja e lidhjes nga parku eolik tek nënstacioni	5/15/2019	240	1/10/2020
Kullat eolike dhe aerogjeneratorët	1/10/2020	963	8/30/2022
Linja e transmetimit Elbasan-Durrës	7/1/2020	729	6/30/2022
Punime përgatitore dhe vepra aksesore Linja e interkoneksionit Durrës-Puglia	2/1/2019	434	4/10/2020
Pozicionimi i kavos detare nga Durrësi për linjën e interkoneksionit	4/10/2020	933	10/30/2022
Vepra të ndryshme plotësuese	3/1/2018	1720	11/15/2022
Kontrollet e sigurisë së punimeve	9/1/2016	2281	11/30/2022
Kolaudimi i brendshëm	10/9/2017	1878	11/30/2022
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare parku eolik me linjën e interkoneksionit 500 MW AL-IT	11/30/2022	31	12/31/2022
Zgjerimi në 1.000 MW i linjës së interkoneksionit Durrës-Puglia	3/3/2025	576	9/30/2026
Kolaudimi i brendshëm zgjerimi nga 500 MW në 1,000 MW linja e interkoneksionit	9/30/2026	30	10/30/2026
Kolaudimi nga autoritetet shqiptare zgjerimi në 1,000 MW linja e interkoneksionit AL-IT	10/30/2026	31	11/30/2026

